



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Kolegjit Universitar
“Luarasi”
Qershor 2017**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1 Znj. Penny Renwick
Kryetar

Kryetare

PA Renwick

2 Profesor Jeremy Bradshaw

Anëtar

Jeremy Bradshaw

3 Dr. Diturije Ismaili

Anëtare

Diturije Ismaili

Datë: 29-30 qershor 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	7
Raporti i detajuar.....	9
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	9
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	13
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	17
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	21
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	26
Lista e dokumenteve	30

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që kanë hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i vlerësimit drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre.

Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Shkolla e lartë universitare jopublike "Luarasi" u licensua në vitin 2003 dhe akreditimin e parë e mori në vitin 2008 për një periudhë gjashtë vjeçare, deri në vitin 2014. Në vitin 2015 ndryshoi emrin në Kolegji Universitar Luarasi (Kolegji Universitar, KUL). Fillimisht përbëhej vetëm nga Fakulteti i drejtësisë dhe ofronte një program studimi katërvjeçar në Drejtësi. Që prej vitit 2012, në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, misionin dhe objektivat, KUL-ja është zgjeruar duke ofruar disa programe të reja të nivelit Bachelor dhe Master me kohë të plotë, në fushat e drejtësisë dhe ekonomisë. Të diplomuarit mund të kontribuojnë në dy shtylla kryesore të zhvillimit dhe demokratizimit të shtetit: në sistemin e drejtësisë dhe në fushat e ekonomisë. Programet e hapura së fundmi janë në proces akreditimi. KUL-ja tashmë ofron tre programe Bachelor, pesë programe Master profesional dhe katër programe Master të Shkencave.

Të gjitha programet janë me kohë të plotë dhe zhvillohen në gjuhën shqipe. Në programet e ciklit të parë studiojnë 389 studentë, ndërsa në programet e ciklit të dytë studiojnë 174 studentë. Deri më tani janë diplomuar 600 studentë.

Gjatë kohës së zhvillimit të këtij vlerësimi, Kolegji Universitar kishte në përbërje dy fakultete: Fakultetin e Drejtësisë, me departamente në të Drejtën Private, të Drejtën Penale dhe të Drejtën Publike; dhe Fakultetin Ekonomik, me departamente në Financë-Bankë, Administrim Biznesi dhe Ekonomiks. Gjithashtu, ka edhe dy njësi të kërkimit shkencor, Laboratorin e Informatikës dhe Laboratorin e Kriminologjisë. Kolegji Universitar ka 43 anëtarë të stafit akademik të brendshëm dhe 38 anëtarë të jashtëm.

Raport i përmbledhur

Kolegji Universitar "Luarasi" (KUL) është institucion privat me godina të vendosura në qendër të qytetit, i cili ushtron veprimtarinë e tij që prej vitit 2003. Gjatë kohës së zhvillimit të këtij vlerësimi, KUL kishte 389 studentë të regjistruar në tre programe Bachelor, në pesë programe Master profesional dhe në katër programe Master të Shkencave. Kolegji Universitar ka 43 pedagogë me kohë të plotë dhe 38 pedagogë me kohë të pjesshme të punësuar pranë dy departamente, në Departamentin e Drejtësisë dhe Departamentin Ekonomik.

Një grup nga Kolegji Universitar "Luarasi" hartoi raportin e vetëvlerësimit, që përfshinte drejtues të nivelit të lartë, personel akademik dhe mbështetës, dhe një përfaqësues të studentëve. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë brenda Kolegjit Universitar, përpara përfundimit dhe miratimit të tij nga Rektori.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, në datat 29 dhe 30 qershor 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Larmia e informacionit mbështetës, e siguruar nga Kolegji Universitar, i mundësoi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm njohjen me strukturën, politikën dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë në drejtim të formimit profesional të ndërmarrë. Dokumentet e shqyrtuara përfshinin: Statutin e Kolegjit Universitar, rregulloret akademike, raportin vjetor, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme, shembujt e informimit rreth programeve dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin mbështetës dhe atë administrativ, si dhe me partnerë, alumni dhe punëdhënës. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të ambientet e mësimdhënies, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët e kompjuterave dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Struktura drejtuese e Kolegjit Universitar "Luarasi" është e përshtatshme dhe efikase, e cila i mundëson institucionit përmbushjen e misionit, vizionit dhe objektivave të tij. Kolegji Universitar drejtohet si një subjekt i pavarur juridik që merr vendime të plota lidhur me veprimtaritë e tij akademike dhe administrative.

Struktura e qeverisjes përcaktohet qartësisht në statutin dhe rregulloret e Kolegjit Universitar. Këto garantojnë autonominë dhe lirinë akademike të tij, dhe Statuti është baza e veprimtarive arsimore dhe kërkimore të Kolegjit Universitar. Kolegji Universitar ka një strategji zhvillimi gjithëpërfshirëse. Në përputhje me praktikën e tij të këshillimit gjithëpërfshirës, Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2016-2020 është rezultati i punës bashkëpunuese me kontribute të ofruara nga të gjitha grupet e stafit dhe studentëve. KUL-ja i ka dhënë prioritet bashkëpunimit me organet e jashtme në Planin Strategjik të Zhvillimit 2016-2020. Ai synon zhvillimin e bashkëpunimit efikas në nivel vendor dhe kombëtar në arsimim dhe kërkim me institucione homologe dhe me organet publike dhe civile, përfshirë prefekturën, qarkun, bashkinë, dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa në nivel ndërkombëtar, KUL-ja synon angazhimin në projekte kërkimore me universitete partnere.

Senati akademik është organi përgjegjës për hartimin dhe propozimin e strategjisë institucionale, siç përcaktohet në Statut. Plani Strategjik përcakton prioritetet e mësimdhënies dhe kërkimeve, dhe parashikon plane veprimi me objektiva të qarta. Progresi drejt synimeve strategjike monitorohet nga vlerësimi vjetor i treguesve të performancës, që kryhet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Struktura administrative e Kolegjit Universitar funksionon me efektshmëri, duke lejuar shpërndarjen e lirë të informacionet në të gjitha nivelet e institucionit, dhe duke nxitur punën në grup dhe frymën e bashkëpunimit.

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk panoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. KUL-ja ndjek politika të qarta dhe të hapura për burimet njerëzore që mbulojnë rekrutimin dhe punësimin e personelit, që përmbushin kërkesat rregullatore. Shumica e stafit akademik të KUL-së janë të punësuar me kohë të pjesshme. Në këtë staf bëjnë pjesë profesionistë nga fushat e drejtësisë dhe ekonomisë, që pasurojnë procesin e mësimdhënies me njohuri të specializuara dhe praktike. Në këto profesionistë përfshihen edhe gjykatës të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, prokurorë, noterë, avokatë dhe shkencëtarë. Kjo praktikë i ka sjellë shumë përfitime Kolegjit Universitar, përfshirë garantimin që programet e studimit të mbulojnë praktikën aktuale, caktimin në praktikë profesionale dhe stazh, dhe mundësi më të mëdha punësimi për të diplomuarit. Stafi vlerësohet vazhdimisht nga pyetësorët e studentëve, dhe nga mbikëqyrja e mësimdhënies gjatë leksioneve. KUL-ja është një subjekt juridik privat që vepron si një shoqëri tregtare. Administratori i shoqërisë dhe Zyra e Financës janë përgjegjës për menaxhimin financiar të KUL-së, që ushtron veprimtarinë e saj nën kontrollin e shoqërisë aksionare "Panorama Group". KUL-ja ka sisteme informacioni të koordinuara, që përfshijnë një bazë të dhënash personale, të regjistrimit, të frekuentimit dhe performancës së studentëve, që menaxhohen nga Arkiva. Kolegji Universitar po punon për të prezantuar një bazë të re digjitale të dhënash, në mënyrë që të lehtësohet më shumë mbarëvajtja e veprimtarive për studentët dhe personelin. Në vitin 2016, KUL-ja nënshkroi një marrëveshje qiraje 20 vjeçare për një ish shkollë me konvikt nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ndërtesa është rinovuar sipas standardeve më të larta, në mënyrë që të ishte më e përshtatshme për veprimtaritë e mësimdhënies.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk panoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. KUL-ja ofron programe që përputhen me misionin e saj për t'u vendosur si "një qendër e ekspertizës akademike, e specializuar në studimet ligjore dhe ekonomike". Programet kanë orientim profesional, lidhen ngushtësisht me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit, dhe janë zhvilluar në bashkëpunim me palët e interesit. KUL-ja ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe ndërmarrje private, për vendosjen në praktika profesionale dhe stazhe. Ai ruan marrëdhënie të ngushta dhe të shëndosha me punëdhënësit dhe alumni dhe shumë nga stafi akademik me kohë të pjesshme mundësojnë stazhe për studentët. KUL-ja synon pasurimin e ofertës akademike me programe të reja, që përmbushin kërkesat e tregut të punës. Rregulloret e Brendshme të Luarasis përcaktojnë kriteret e përgjithshme të pranimit, ndërsa kriteret specifike të pranimit përcaktohen nga rregulloret e programit dhe miratohen nga Senati Akademik. KUL-ja ruan lidhje me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe me shkollat e mesme, ndërsa stafi, përfshirë akademikë të nivelit të lartë, bëjnë vizita në shkolla të mesme dhe marrin pjesë në panairë të punës. Departamentet, në bashkëpunim me partnerët e jashtëm dhe me alumni, dhe të mbështetur nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, kanë paraqitur propozime për programe të reja studimi. Senati bën mbikëqyrjen përfundimtare të të gjitha programeve arsimore. KUL-ja promovon kulturat e huaja, nëpërmjet leksioneve të hapura dhe një sërë mundësish për konkurse dhe programe shkëmbimi ndërkombëtare, si për shembull Projekti "Alpha" në Austri dhe një konkurs biznesi të organizuar nga Ambasada Amerikane.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Programet e studimit janë të organizuara. Praktika profesionale është një lëndë me detyrim për programet e ciklit të parë dhe të dytë dhe zhvillohet në si në laboratorët mjeko-ligjore dhe të informatikës së Kolegjit Universitar, ashtu edhe në institucione të ndryshme, si në Gjykata dhe në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (Morgu), nën mbikëqyrjen e përbashkët të departamentit dhe institucionit pritës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si praktikë të mirë mundësitë e praktikës gjithëpërfshirëse dhe cilësore profesionale, që i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme për një karrierë të suksesshme. Përmirësimi i programeve të studimit arrihet me anë të disa proceseve të ndërthurura, përfshirë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani, anketimet semestrale të studentëve dhe vizitat e vlerësimit të performancës, të organizuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Gjatë vlerësimit vjetor të performancës së stafit, bisedohet me stafin për të identifikuar pikat e tyre të forta dhe të dobëta, dhe stafit me performancë të ultë iu jepet kohë për t’u përmirësuar. Në përputhje me misionin e saj, KUL-ja synon përgatitjen e studentëve për nivelet elitare në fushat e ekonomisë dhe drejtësisë dhe planet e saj kërkimore mbështeten në këto fusha. KUL-ja bashkëpunon me qendra të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit dhe organizon një sërë veprimtarish në bashkëpunim me institucione të tjera kërkimore, si Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Barit, dhe Shkolla e Magjistraturës.

Në mënyrë që të rrisë kapacitetet, Kolegji Universitar nxit angazhimin në projekte me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Ka marrë pjesë në projekte, si “SALTUM” në bashkëpunim me universitete në SHBA, Kinë, Brazil dhe Itali. Për më tepër, e ka zgjeruar bashkëpunimin me Universitetin e Lodz në Poloni, dhe me Universitetin e Burgenland në Austri, duke mundësuar mobilitetin e studentëve. Ka lidhur disa marrëveshje partneriteti dhe po lidh disa të tjera me Institutin Shqiptaro-Amerikan, me British Council, dhe me Institutin Demokratik Kombëtar. Me ndryshimet në ligjin e ri, KUL-ja krijoi qendrën “LUARASI IDEA”, si një subjekt të veçantë ligjor, në mënyrë që të lehtësohej aplikimi për financimet e jashtme dhe për të lehtësuar zhvillimin e kërkimeve brenda Kolegjit Universitar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron punën e kërkimit shkencor si thelbësore në kontekstin e fazës së zhvillimit të KUL-së dhe programet e ofruara, që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi veprime tashmë të ndërmarrë. Regjistrimi i studentëve mbështetet në legjisllacionin aktual dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional. KUL-ja iu ofron studentëve këshillime dhe mbështetje përmes zyrave për studentët. Gjithashtu ofron edhe këshillim për karrierën, me anë të së cilës studentët mund të marrin informacione për organizimin e forumeve të hapura, trajnimeve, stazheve, dhe veprimtarive sociale dhe sportive. Politika e tutorimit përcakton se si stafi akademik e zhvillon procesin e mentorimit, dhe studentët u shprehën pozitivisht për mbështetjen e marrë dhe për disponueshmërinë e stafit. Për më tepër, u shprehën se stafi i konsideron ata si kolegë. Kolegji Universitar i pajis studentët me literaturën që gjendet në bibliotekë dhe me materiale të shkruara nga pedagogët dhe të botuara nga Shtypi i Universitetit Luarasi dhe biblioteka. Studentët organizojnë veprimtari të ndryshme në përputhje me kuadrin e Këshillit Studentor dhe vetëpërfaqësohen në strukturat qeverisëse të mësimdhënies dhe ato kërkimore brenda Kolegjit Universitar. KUL-ja ofron ndihmë financiare për organizimin e veprimtarive dhe Këshilli ka krijuar klubin dhe gazetën e studentëve. Gjithashtu, ka krijuar dhe marrëdhënie me një Këshill Studentor në Kosovë. Kolegji Universitar ndjek politika për punësimin e të diplomuarve të tij, për shembull, duke iu ofruar klinikë ligjore, qëllimi kryesor i së cilës është ofrimi i ndihmës ligjore në gjykata për ato persona që nuk i përballojnë shpenzimet dot për mbrojtjen e tyre ligjore. Ka lidhur 29 marrëveshje bashkëpunime, shumë

prej të cilave me institucione dhe ndërmarrje publike dhe private, si Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Policia e Shtetit, Drejtorja e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, Grupi Hysenbelliu dhe një sërë përfaqësuesish të sistemit gjyqësor të Shqipërisë; disa individë nga këto organizata janë të punësuar si staf me kohë të pjesshme. Këto bashkëpunime iu sigurojnë studentëve një sërë mundësish të mira për stazhe. Disa prej këtyre mundësive kanë rezultuar në punësim të menjëhershëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikon mbështetjen e gjerë të punësueshmërisë ofruar KUL-së nga profesionistë të nivelit të lartë dhe nga ekspertë, si stafi akademik me kohë të pjesshme, si praktikë e mirë.

Në arritjen e këtyre gjykimëve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikave të mira, të cilat Kolegji Universitar dëshiron jo vetëm t'i zhvillojë më tej, por edhe t'i përhapë në sektorin e arsimit të lartë shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandoi Kolegjit Universitar të shqyrtonte mënyrat e sigurimit të mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij dhe të përmirësimit të mëtejshëm të përvojës së studentëve.

Kolegji Universitar "Luarasi" e ndërmori vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e vlerëson nivelin e angazhimit të Kolegjit Universitar në këtë proces dhe bashkëpunimin e tij me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Znj. Penny Renwick (Kryetar), Dr. Diturije Ismaili dhe Profesor Jeremy Bradshaw (Anëtarë).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se Standardet e Cilësisë janë përmbushur plotësisht në pesë fusha e vlerësimit.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- mundësitë e praktikës gjithëpërfshirëse dhe cilësore profesionale, që i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme për një karrierë të suksesshme (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1**)
- mbështetja e gjerë për punësueshmërinë në KLU e ofruar nga profesionistë të nivelit të lartë dhe ekspertë si staf akademik me kohë të pjesshme (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë përbushur **plotësisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, të Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Kolegjin Universitar “Luarasi”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur plotësisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 KUL-ja u themelua në vitin akademik 2003-2004, nën kuadrin e Statutit të hartuar në përputhje me ligjin nr. 8461, datë 25.02.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 22.03.2001 "Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë". Statuti përbën bazën e veprimtarive arsimore dhe kërkimore të KUL-së. **[RVV fq.11-12; 1]** KUL-ja e rishikon dhe ndryshon Statutin dhe rregulloret mbështetëse sipas kërkesave, në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e bëra në kuadrin ligjor dhe rregullator të vendit. Versioni i dorëzuar u publikua në shtator të vitit 2016, **[1; 2]** në mënyrë që të përfshiheshin kërkesat e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2016 " Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin nr. 515, datë 27.10.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. **[RVV fq.12; 1; 2][Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Struktura drejtuese e KUL-së është e efektshme dhe përcaktohet qartësisht në Statutin dhe rregulloret e tij. **[RVV fq.13; 1; 2]** Senati akademik, Asambleja e Stafit dhe disa komisione të përhershme janë përgjegjëse për drejtimin e veprimtarive akademike. **[RVV fq.12; 1]** Rektori përbëhet nga Rektori, zëvendës rektorët, Administratori i KUL-së dhe përgjegjësit e njësive kryesore. **[RVV fq.13; 1]** Ka edhe një Këshill Etike. **[RVV fq.13; 1]** Ka dy fakultete akademike, secila e përbërë nga tre nënnjësi: **[RVV fq.13; 1; 2]** Fakulteti i Drejtësisë, me Departamentet e së Drejtës Publike, së Drejtës Penale dhe së Drejtës Private; dhe Fakulteti Ekonomik, me Departamentet Financë-Bankë, Administrim Biznesi dhe Ekonomiksit. **[RVV fq.13; 1]** Stafi i nivelit të lartë u shprehën se, edhe pse kërkesat ligjore diktojnë një strukturë administrative, ato funksionojnë me efektshmëri për KUL-në, duke lejuar shpërndarjen e lirë të informacionet në të gjitha nivelet e institucionit, dhe duke nxitur punën në grup dhe frymën e bashkëpunimit. **[M3][Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 KUL-ja e vlerëson kontributin e palëve të interesit në procesin e diskutimit dhe vendimmarrjes. **[RVV fq.12-13; M1; M3; M4; M7]** Senati akademik, Rektori, dekanët dhe departamentet mbledhen rregullisht në përputhje me Statutin, dhe për mbledhje të jashtëzakonshme, sipas rasteve. **[RVV fq.14; 1; EA1-5; EA1-6]** KUL-ja respekton, merr në konsideratë dhe diskuton gjerësisht rreth opinioneve dhe propozimeve të të gjitha grupeve të personelit dhe studentëve, lidhur me ruajtjen e kulturës së KUL-së, që iu garanton të gjithëve lirinë e fjalës dhe të shprehjes dhe pjesëmarrjen aktive në diskutime dhe debate. **[RVV fq.14; M1; M3; M4; M7]** Raporti i Vetëvlerësimit **[RVV fq.14]** deklaron që, "Materialet për diskutim të përfshira në axhendë, i janë dhënë paraprakisht në format me shkrim dhe elektronik të gjithë anëtarëve të organeve përkatëse, dhe secili anëtarë është i lirë të diskutojë dhe të japë mendimin e tij dhe të diskutojë për tema të ndryshme me kolegët". **[EA1-5; EA1-6]** KUL-ja respekton zërin e studentëve; **[RVV fq.14]** ka studentë të zgjedhur që janë anëtarë të Senatit Akademik, Bordit të Etikës dhe të gjitha komisioneve të përhershme institucionale. **[2; EA1-1]** Pas zgjedhjeve, studentët anëtarë të komisioneve marrin pjesë në trajnime orientimi në një mjedis joformal. **[EA1-2; M4]** Stafi i nivelit të lartë konfirmon se mendimi i studentëve është i rëndësishëm në përcaktimin e strategjisë. **[M3][Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.4 KUL-ja i respekton kufijtë e tij të autonomisë. Në kuadër të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", KUL-ja ka autonomi të plotë dhe liri akademike, që përcaktohen dhe rregullohen në Statut, rregullore, listën e programeve të studimit dhe kriteret e studimit. **[RVV fq.15; 1; 3; 8; 44]** Në përputhje me ligjin, janë miratuar programe të veçanta studimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[33][Kapitulli III Standardi I.4]**

- 1.5 Kolegji Universitar ka një strategji gjithëpërfshirës zhvillimi. Në përputhje me kulturën e tij të këshillimit gjithëpërfshirës, Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2016-2020 është rezultati i punës bashkëpunuese të personelit akademik dhe administrativ, me kontribute të ofruara nga të gjitha grupet e stafit dhe studentëve.**[RVV fq.16; 4; M1; M3; M4; M5; M7]** Senati akademik është organi përgjegjës për hartimin dhe propozimin e strategjisë institucionale, siç përcaktohet në Statut.**[RVV fq.16; 43 fq.2]** Bordi i Administrimit miraton Planin Strategjik dhe zbatimin e tij.**[83 art 31; M5]** Plani Strategjik përcakton prioritetet për mësimdhënien dhe veprimtarinë kërkimore, përfshin analizën e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe rreziqeve, dhe parashikon plane veprimi me synime të qarta dhe me mekanizma të nevojshme, për t'i arritur këto objektiva afatshkurtra dhe afatgjata. **[4]** Progresi drejt synimeve strategjike monitorohet nga vlerësimi vjetor i treguesve të performancës, që kryhet nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**[37 fq.7, FE17 ; FE17; M2; M3]** **[Kapitulli III Standardi I.5]**
- 1.6 KUL-ja i përmbush detyrimet ligjore, duke hartuar një Raport Vjetor të Veprimtarisë Akademike. Çdo raport paraqet një analizë të detajuar të të gjitha njësive akademike dhe administrative të Kolegjit Universitar, dhe përfshin edhe kontribute nga studentët dhe palët e jashtme të interesit.**[RVV fq.16; 13; M2; M6; M7]** Raporti Vjetor miratohet nga Bordi i Administrimit dhe nga Senati Akademik, i cili para se t'i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit bëhet i disponueshëm për stafin akademik dhe studentët, përmes publikimit në faqen e internetit të institucionit.**[RVV fq.16; <http://www.luarasi-univ.edu.al/raport-vjetor/>]** Rektorati dhe departamentet përkatëse dhe zyrat e dekanëve monitorojnë progresin me anë të veprimeve të identifikuar nga raportet. Senati diskuton për zbatimin dhe identifikon nëse ka kërkesa për përmirësim të mëtejshëm. I gjithë procesi mundësohet nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**[FE17; FE2; FE24; M3]****[Kapitulli III Standardi I.6]**
- 1.7 Siç përmendet në pikën 1.2, struktura drejtuese e Kolegjit Universitar “Luarasi” është e përshtatshme dhe efikase, e cila i mundëson institucionit përmbushjen e misionit, vizionit dhe objektivave të tij. Kolegji Universitar menaxhohet si një subjekt i pavarur ligjor që merr vendime të plota lidhur me veprimtaritë e tij akademike dhe administrative.**[RVV fq.17; 1; 2; 5; 6; 18]** **[Kapitulli III, Standardi II.1]**
- 1.8 Statuti dhe rregulloret përcaktojnë strukturën drejtuese të institutit dhe nënjesive të tij.**[RVV fq.17; 1; 2; 3; 5; 6]** Këto dokumente garantojnë autonominë e Kolegjit Universitar dhe lirinë akademike të tij në të gjitha veprimtaritë. KUL-ja merr vendime përmes diskutimeve të hapura dhe veprimtarive të grupeve të punës.**[M1; M2; M3; M4; M5; M7]** Në varësi të temës, diskutimi mund të përfshijë kontribute nga stafi akademik, personeli mbështetës, dhe studentët.**[67; 69; 46; EA1-6]** Këshilli studentor iu ofron studentëve të KUL-së një mekanizëm formal përmes të cilit ata mund të japin mendimet e tyre për planet dhe programet e studimit, për rregulloret, dhe për çdo çështje tjetër, që ndikojnë te studentët apo te studimet e tyre, dhe kjo diskutohet më me detaje në pikën 5.7.**[59; 83]** Këshilli Studentor siguron përfaqësimin e studentëve në komisionet institucionale.**[59; M4]****[Kapitulli III Standardi II.3]**
- 1.9 KUL-ja pohon se kurrikulat e programeve të studimit të KUL-së duhet të përshtaten me profesionet që studentët e tij do të ushtrojnë, dhe se programet që ofron duhet të përmirësohen nga kërkesa e tregut.**[RVV fq.17]** Megjithatë, në Raportin e Vetëvlerësimit është shënuar se duhet përmirësuar studimi i tregut të punës lidhur me hapjen e programeve të reja dhe novatore në mbështetje të studentëve të ardhshëm, dhe organizimi i veprimtarive periodike me alumni, në përmirësim të kurrikulave mbështetur në kërkesat dhe praktikën e tregut. Pas vlerësimit, programet e studimit në KUL u hartuan dhe u zhvilluan për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Gjatë këtij procesi, KUL-ja u këshillua nga persona të jashtëm si: stafi akademik me kohë të pjesshme, punonjësit, partnerët e

jashtëm dhe alumni. **[13; 47; 49; EA1-9; EA1-10; M6]** Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës ndjek ecurinë e studentëve pas diplomimit, dhe ka krijuar një rrjet alumni, për të ruajtur marrëdhëniet me alumni. **RVV fq.10; EA1-12 ; M6** *[Kapitulli III Standardi III.1]*

- 1.10 KUL-ja i ka dhënë prioritet bashkëpunimit me organet e jashtme në Planin Strategjik i Zhvillimit 2016-2020. **[4]** Synon zhvillimin e bashkëpunimit efikas në nivel vendor dhe kombëtar në arsimim dhe veprimtari kërkimore me institucione homologe dhe me organe publike dhe civile, përfshirë prefekturën, qarkun, bashkinë, dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa në nivel ndërkombëtar, KUL-ja synon zhvillimin e projekteve kërkimore pjesë të programeve kuadër, të financuara nga Bashkësia Evropiane dhe nga donatorë të tjerë. **[RVV fq.54;4; EA1-14]** *[Kapitulli III Standardi III.2]*
- 1.11 Në mënyrë që të forcojë marrëdhëniet me industrinë dhe profesionet që i përgjigjen programeve të studimit të KUL-së, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume me disa institucione publike dhe private, si Drejtoria e të Drejtave të Autorit në Ministrinë e Kulturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale. Duke marrë pjesë në praktika, studentët përjetojnë dhe përfitojnë nga njohuritë e specialistëve dhe ekspertëve. **[AE15; EA1-15; FE11]** Gjithashtu, ka edhe shumë marrëveshje bashkëpunimi, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, me institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë mundësi shkëmbimi në mësimdhënie, mobilitet të stafit, veprimtari ekstrakurrikulare, veprimtari të përbashkëta kërkimore dhe bashkëpunime për botime të ndryshme. **[RVV fq.20; EA1-15]** Përmes marrëdhënieve me organe të jashtme, KUL-ja ka mundur ta pasurojë procesin e mësimdhënies falë marrëdhënieve me organe të jashtme, përmes konferencave dhe workshop-eve, praktikave profesionale, stazheve dhe çirakërisë. Disa shembuj janë: institucionet e administratës qendrore publike, gjykatat dhe bizneset. **[RVV fq.10; EA1-16 ; EA1-17]** *[Kapitulli III Standardi III.3]*
- 1.12 Programet e studimit të KUL-së zhvillohen në përputhje me procesin e Bolonjës. Falë kësaj mundësohen shkëmbime studentore dypalëshe me institucione të tjera. **[RVV fq.20; 11; EA1-16]** Ai bën transferimin e stafit akademik dhe të studentëve në përputhje me procedurat e përcaktuara në statutin dhe rregulloret e Kolegjit Universitar. **[RVV fq.11; 1; 2]** Mobiliteti i studentëve mundësohet nga një komision i posaçëm, që vendos për ekuivalentimin e kurseve dhe krediteve të programeve, sipas programit të studimit, kur studenti dëshiron t'i transferojë studimet. **[RVV fq.20; 26]** Përmes pjesëmarrjes në projektet e Erasmus+, stafi dhe studentët kanë marrë pjesë në projekte shkëmbimi me universitete Evropiane, dhe përmes diskutimeve në tryeza të rrumbullakët, Kolegji Universitar ka kontribuar në mënyrë konstruktive në reformën në drejtësi dhe në zhvillimin kombëtar të ekonomisë. **[13; 30; EA1-6; EA1-7]** KUL-ja pohon se duhet bërë më shumë në këtë fushë **[RVV fq.22]**, dhe ka punuar shumë për të krijuar partneritete dhe marrëveshje bashkëpunimi, si ato me Universitetin e Burgenlandit në Austri dhe me Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës, në mënyrë që të ofrojë mundësi për mobilitetin e stafit dhe studentëve. **[M1; FE11]** *[Kapitulli III Standardi III.4]*

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Shumica e stafit akademik i KUL-së janë të punësuar me kohë të pjesshme (nga 35 anëtarë të stafit akademik, 22 prej tyre janë me kohë të pjesshme). **[GID]** Praktika e këtij institucioni ka qenë gjithnjë punësimi i stafit në përputhje me kërkesat e programit të studimit, duke sjellë kështu profesionistë të njohur nga fushat e drejtësisë dhe ekonomisë, dhe duke e pasuruar kështu procesin e mësimdhënies me njohuri të specializuara dhe praktike. Në këtë staf përfshihen edhe gjykatës të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, prokurorë, noterë, avokatë dhe shkencëtarë. **[RVV fq.22; 17; M6]** Kjo praktikë i ka sjellë shumë përfitime Kolegjit Universitar, duke përfshirë garantimin që programet e studimit të mbulojnë praktikën aktuale, caktimin në praktikë profesionale dhe stazh, dhe mundësi më të mëdha punësimi për të diplomuarit. Rekrutimi i personelit akademik dhe administrativ përshkruhet në nenin 26 të Rregullores, **[2; 51]** në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 07.22.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, dhe me dispozitat e Statutit. **[2]** Procesi i rekrutimit i ka dhënë përparësi kandidatëve të kualifikuar nga universitete të njohura në fushën ndërkombëtare, siç mund të vihet re në përbërjen aktuale të personelit. **[RVV ; EA2][Kapitulli III Standardi IV.1]**
- 2.2 KUL-ja e mbështet personelin përmes një sërë veprimtarish, që përfshijnë seanca trajnimi, si për shembull Kursi për zhvillimin e pedagogëve, leksione të hapura, debate, dhe veprimtari sociale, kulturore dhe sportive. Këtu përfshihen edhe mundësi trajnimi për stafin e emëruar së fundmi. Gjithashtu, stafi përfiton edhe nga pjesëmarrja në mbledhjet për ofrimin e informacioneve studentëve aktualë dhe maturantëve në të gjithë vendin. **[RVV fq.23; 13; 52; 53; EA2-2; EA4-8; M5]** **[Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 Stafi vlerësohet vazhdimisht me anë të pyetësorëve të studentët (Shihni pikën 2.14), dhe nga mbikëqyrja e mësimdhënies gjatë leksioneve. Në rast se pyetësorët e studentëve evidentojnë një problematikë të mundshme, zhvillohet edhe një seancë tjetër vëzhgimi të mësimi pa e njoftuar paraprakisht pedagogun. Pas kësaj, ofrohen trajnime bazë dhe mundësi zhvillimi, dhe rastet ekstreme të praktikës së keqe kanë rezultuar në shkarkim nga puna. **[AE15; FE9; FE13; M5][Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.4 Gjatë vitit akademik, KUL-ja organizon një sërë veprimtarish sociale dhe sportive për stafin dhe studentët e tij. Këtu përfshihen veprimtari sportive, konkurse, dhe debate për çështje aktuale sociale. **[RVV fq.24; 56]** **[Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.5 Menaxhimi i burimeve njerëzore është efikas dhe kryhet në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Kolegjit Universitar dhe fakulteteve. **[RVV fq.24; 2; 5; 6]** Përgjegjësitë e Kolegjit universitar dhe të punonjësve të tij përcaktohen në kontratën e punës. **[18]** **[Kapitulli III Standardi II.2]**
- 2.6 KUL-ja është një subjekt juridik privat që vepron si shoqëri tregtare, Institucion jopublik i arsimit të lartë, Universiteti “Luarasi” Sh.p.k. **[RVV fq.24; 1; 14; EA2-1]** Buxheti përgatitet nga Administratori i shoqërisë dhe Zyra e Financës, dhe shqyrtohet nga Rektorati dhe Senati Akademik. **[1; EA2-8; EA2-9]** Zbatimi i buxhetit monitorohet nga Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me organet/autoritetet akademike drejtuese. **[RVV fq.25; 1][Kapitulli III Standardi VI.1]**
- 2.7 Administratori i shoqërisë dhe Zyra e Financës janë përgjegjës për menaxhimin financiar të KUL-së, që ushtron veprimtarinë e saj nën mbikëqyrje të shoqërisë aksionare “Panorama Group”. **[RVV fq.25; EA2-1]** Kolegji Universitar përgatit pasqyrat financiare vjetore, në përputhje me kërkesat ligjore. Pasqyrat financiare shqyrtohen nga Senati Akademik **[EA2-8]** dhe nga Bordi i Administrimit, **[EA2-9]** para se t’i dërgohet

Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe autoriteteve tatimore.[RVV fq.25; 12; 15][Kapitulli III Standardi VI.2]

- 2.8 Pasqyrat financiare të KUL-së auditohen çdo vit nga një auditues i pavarur, për të vërtetuar që ato përmbushin standardet e kontabilitetit dhe kërkesat ligjore për shoqëritë tregtare dhe që është kryer një analizë e rrezikut.[RVV fq.25; 16][Kapitulli III Standardi VI.3]
- 2.9 KUL-ja ka sisteme informimi të koordinuara, që përfshijnë një bazë të dhënash personale, të regjistrimit, të frekuentimit dhe performancës së studentëve, që menaxhohen nga Arkiva.[RVV fq.26; fq.30] Kolegji Universitar po punon për të prezantuar një bazë të re dixhitale të dhënash, në mënyrë që të lehtësohet më shumë mbarëvajtja e veprimtarive për studentët dhe personelin. Do të vihet në përdorim në korrik të vitit 2017 [M3] dhe do të përfshijë shënime për personelin akademik dhe administrativ, studentët, alumni dhe palë të tjera të interesit, dhe po zgjeron rrjetin e tij të bibliotekës online, për t'iu përgjigjur nevojave të stafit akademik dhe studentëve.[RVV fq.31; 4; FE1; M3] KUL-ja ka një faqe interneti, një llogari në Facebook dhe në YouTube.[45] Sekretaritet e dy fakulteteve mbledhin dhe sistemojnë të dhënat e performancës së studentëve. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i vlerëson dhe i analizon të dhënat dhe i ndan me stafin akademik, për t'i ndihmuar të përmirësojnë performancën e tyre në mësimdhënie.[AE15; M5][Kapitulli III Standardi VII.1]
- 2.10 Në KUL, ambientet e mësimdhënies janë të pajisura me mjetet e duhura teknologjike për mësimdhënien, duke përfshirë kompjutera, projektorë, dhe akses në internet. Zyra e TI-së i menaxhon këto burime për t'iu ofruar personelit dhe studentëve shërbime të besueshme.[RVV fq.26; 58] Kolegji Universitar ka një laborator kompjuterash me kapacitet prej 25 studentësh.[RVV fq.26; 58; Turi] Studentët janë shprehur të kënaqur me disponueshmërinë e mjeteve dhe softuerëve teknologjikë.[M4] Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi cilësinë dhe sasinë e burimeve të teknologjisë së informacionit dhe shpejtësinë dhe besueshmërinë e lidhjes Wi-Fi të internetit.[Turi][Kapitulli III Standardi VII.2]
- 2.11 KUL-ja i menaxhon asetet e saj në mënyrë të efektshme dhe në përputhje me planin e tij strategjik.[RVV fq.26; 4] Në vitin 2016, Kolegji Universitar nënshkroi një marrëveshje qiraje 20-vjeçare me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ish konviktin e Shkollës së Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, Tiranë. Ndërtesa është rinovuar sipas standardeve më të larta, në mënyrë që të ishte më e përshtatshme për veprimtaritë e mësimdhënies. Studentët u shprehën se janë të kënaqur me cilësinë e ambienteve.[RVV fq.26;39; M4; Turi][Kapitulli III Standardi VII.3]
- 2.12 Veprimtaria akademike e Kolegjit Universitar regjistrohet dhe ruhet në formën e publikimeve akademike, seancave të konferencave dhe workshop-eve, dhe përmes publikimeve përkatëse. KUL-ja ruan një kopje të tyre në bibliotekë, si edhe një tjetër në formatin elektronik.[RVV fq.27; 59][Kapitulli III Standardi VII.4]
- 2.13 Ambientet dhe burimet e mësimdhënies në KUL plotësojnë të gjitha kërkesat të Udhëzimit nr. 11 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, të datës 28.02.2011, “Procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licensës.[RVV fq.27; 22; Turi][Kapitulli III Standardi VII.5]
- 2.14 Anketimet periodike të studentëve përmbajnë pyetje për burimet e të nxëniet, ambientet dhe logjistikën.[RVV fq.27; 60] Kolegji Universitar i analizon me kujdes reagimet e këtyre anketimeve, që kontribuojnë në përcaktimin e prioritetëve buxhetore, siç pohuan studentët për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. RVV fq.27; 60; M4] Në

përputhje me marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2016, KUL-ja i ofron Institutit për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen zyra, mbështetje logjistike dhe ambiente të tjera administrative.**[61]** Aktualisht, nuk ka marrëveshje për ofrimin e shërbimeve ndaj palëve të treta.**[RVV fq.27][Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.15 KUL-ja ushtron veprimtarinë në një godinë që është ristrukturuar sipas një standard të lartë. Është rinovuar dhe ristrukturuar duke përdorur me materiale cilësore moderne dhe i përmbush të gjitha kushteve teknike dhe higjieno-sanitare, që nevojiten për të funksionuar. Sallat e seminareve janë të izoluara nga zhurma, me ajër të kondicionuar dhe të pajisura me teknologjinë e nevojshme për të nxënësit. Ambientet e mësimdhënies ofrojnë akomodimin e duhur për numrin aktual të studentëve. Godina ka një sistem për mbrojtjen nga zjarri, që kontrollohet rregullisht nga autoritetet përkatëse.**[RVV fq.28; 39; 62][Kapitulli III Standardi V.1]**

2.16 Zyrës e Arkivit është përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e dokumenteve në format të shtypur, në përputhje me legjislacionin përkatës. Njësia përkatëse bëhen hedhjen e të dhënave institucionale në format elektronik.**[RVV fq.28]** Menaxhimi i të gjithë dokumentacionit, në format elektronik ose të shtypur, është përgjegjësi e Sekretarisë Mësimore, në përputhje me dispozitat e rregulloreve.**[2][Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 KUL-ja ofron programe në përputhje me misionin e tij për t'u vendosur si “një qendër të ekspertizës akademike, e specializuar në studimet ligjore dhe ato ekonomike”. Programet janë të lidhura ngushtësisht me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. **[RVV fq.31; 4; GID; M1; M3; M6]** Senati Akademik i miraton programet e reja, **[1; 2]** dhe KUL-ja ofron një sërë programesh të ciklit të parë dhe të dytë në degët e drejtësisë dhe ekonomisë. **[RVV fq.31; 9; 10]** Faqja e internetit e KUL-së paraqet një përmbledhje të programeve të studimit. Gjithashtu, kanë prodhuar dhe disa fletëpalosje për programet e studimit. **RVV fq.31; <http://www.luarasi-univ.edu.al/>; 52]** Rregulloret e Brendshme të Luarasis përcaktojnë kriteret e përgjithshme të pranimit, ndërsa kriteret specifike të pranimit përcaktohen në Rregulloret e programit dhe miratohen nga Senati Akademik. **[RVV fq.31-32; 2; 7; EA3.2; FE3.4, FE3.6]** KUL-ja ruan lidhje me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe me shkollat e mesme, ndërsa stafi, përfshirë akademikë të nivelit të lartë, bëjnë vizita në shkolla të mesme dhe marrin pjesë në panairë të punës. **[RVV fq.31; EA3.1; M5; M7]** Në anketimin e studentëve, të gjithë studentët pohuan se KUL-ja iu kishte ofruar ato që kishte promovuar dhe se programi i përmbush mjaftueshëm pritshmëritë e tyre. Studentët që takoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u shprehën pozitivisht për informacionet e marra, gjë që përcaktoi vendimin e tyre fillestar. **[Anketimi i studentëve; M4]** Anketimi i stafit pohoi se 90 për qind e stafit i konsideron si të mjaftueshme informacionet që i ofrohen publikut. **[Anketimi i stafit] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Aktualisht, KUL-ja ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë me kohë të plotë në degët e drejtësisë dhe ekonomisë. **[RVV fq.32; GID]** Programet e zhvilluara në vitin 2012 janë ende në proces akreditimi. **[GID; 8; M1]** KUL-ja është në proces e sipër për krijimin e mundësive të reja për sa i përket edukimit në vazhdim dhe shkollave verore, si për shembull, për vëzhgues zgjedhjesh dhe për burgje, dhe aspiron që të ofrojë edhe kredite për këto module. **[RVV; fq.32; M1; M2; M5][Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.3 KUL-ja po punon me Planin e tij Strategjik të Zhvillimit 2016-2020 dhe programet e studimit të ofruara janë në përputhje me të. **[RVV fq.33; 4; M3]** KUL-ja synon ta pasurojë ofertën e saj akademike me programe të reja, që përmbushin kërkesat e tregut të punës, të cilat përfundimisht i dërgohen Senatit për miratim. **[RVV fq.40; M1; M3; M5; M6]** Programet kanë rezultate të caktuara. **[RVV fq.33; EA3.6]** Dokumentacionet e dorëzuara për syllabusin për sa i përket modulit, nuk specifikojnë objektivat e të nxëniet, megjithatë, gjatë intervistës studentët u treguan shumë të qartë për rezultatet e pritura të të nxëniet. **[10; M4]** Ofron suplemente të diplomave, ku përcaktohen modulet e studiuara. **[EA3.8]** Në anketimin e studentëve, të gjithë studentët pohuan se modulet i përmbushin qëllimet dhe objektivat e programit. **[Anketimi i Studentëve; M4] [Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.4 KUL-ja e ushtron veprimtarinë e saj vetëm në Tiranë dhe të gjitha programet e saj i ofron në këtë qytet. **RVV fq.33; GID]** Gjuha angleze përfshihet në të gjitha programet e ciklit të parë. **[RVV fq.33; 8; 9]** dhe në Raportin e Vetëvlerësimit KUL-ja ka theksuar se synon që t'i zhvillojë në anglisht disa lëndë. **[RVV fq.40]** KUL-ja promovon kulturat e huaja përmes leksioneve të hapura nga lektorë të huaj dhe përmes një sërë mundësish për konkurse dhe programe shkëmbimi ndërkombëtare, si për shembull Projekti “Alpha” në Austri dhe një konkurs biznesi, të organizuar nga Ambasada Amerikane që angazhonte edhe studentë të KUL-së. **[RVV; fq.34; M1; M3; M4][Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.5 KUL-ja ka 43 pedagogë me kohë të plotë dhe 38 pedagogë me kohë të pjesshme. **[GID]** Në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe me Statutin dhe Rregulloret e institucionit, Kolegji Universitar e menaxhon me kujdes ngarkesën mësimore të stafit, në mënyrë që ata të kenë mundësi të angazhohen në veprimtari të tjera, si kërkimi ose administrimi, të cilat miratohen nga Senati Akademik. **[RVV fq.34; 1;**

2] Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave administron planet mësimore dhe programet e lëndëve.**[2] [Kapitulli I Standardi I.5]**

- 3.6 Në mënyrë që të sigurohet se programet e studimit janë të kuptueshme dhe se objektivat e tyre janë qartësisht të përcaktuara, departamentet propozojnë programe të reja, në bashkërendim me partnerët e jashtëm dhe me alumni dhe me mbështetjen e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Senati kryen mbikëqyrjen përfundimtare të të gjitha programeve arsimore.**[RVV fq.35; 1; M3; M5; M6; M7]** Modulet dhe kreditet për çdo program janë shpjeguar qartësisht.**[RVV fq.35; 8]** Me miratimin e Senatit Akademik mund të riorganizohet deri në 20 për qind e programit.**[2]** Udhëzuesi i studentëve përmban modulet dhe kreditet për secilin program.**[21]** Rregulloret e Brendshme të Luarasi përcaktojnë kriteret e përgjithshme të pranimit, ndërsa kriteret specifike të pranimit përcaktohen nga rregulloret e programit.**[RVV fq.31-32; 2; 7; EA3.2]** Gjithashtu, faqja e internetit e KUL-së ofron një përmbledhje të programeve të studimit.**[RVV fq.35; <http://www.luarasi-univ.edu.al/>][Kapitulli I Standardi I.6]**
- 3.7 Programet e ciklit të parë iu ofrojnë studentëve metodat bazë të njohurive teorike.**[RVV fq.35; 8]** Siç përcaktohet në Rregulloret institucionale dhe të programeve, të gjitha programet parashikojnë një kalim progresiv nga cikli i parë në të dytin.**[RVV fq.35; 1; 2]** Në mënyrë që të pranohen në një program të ciklit të dytë, aplikantët duhet të kenë mbaruar nivelin Bachelor në degët përkatëse.**[RVV fq.35; 2; 26]** Rregulloret përmbajnë disa dispozita për studentët që i lejojnë ata t'i transferojnë studimet e tyre, por megjithëse kjo mundësi nuk është përcaktuar në Udhëzuesin e studentëve, ata e kuptojnë shumë mirë procesin që duhet ndjekur.**[10; 50; M4]** Programet e ciklit të parë i përgatisin studentët për punësim ose për studimet e ciklit të dytë, dhe nëse një student është në marrëdhënie pune gjatë studimeve të ciklit të dytë, përvoja e tyre në punë pranohet si praktikë profesionale.**[RVV fq.35; 2; 67]** Programet e studimit përputhen me procesin e Bolonjës dhe mundësojnë transferime dypalëshe të studentëve. Procedurat përcaktohen në Rregulloret dhe Statutin e Kolegjit universitar.**[RVV fq.35; 1;1; 26]**
[Kapitulli I Standardi I.7]
- 3.8 Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës i mbështet studentët gjatë studimeve të tyre, që nga orientimi fillestar e deri te punësimi.**[RVV fq.35; 2; Turi; M7]** Ekziston një kuadër rregullator për menaxhimin e gjetjes së praktikave profesionale.**[67]** KUL-ja ka disa marrëveshje zyrtare tutoriati dhe tutorët shpenzojnë të paktën një orë në javë për të ofruar këshillimi/udhëheqje. Përgatitja për praktika profesionale dhe për tezat e diplomës përbëjnë marrëveshjet e tutoriatit.**[RVV fq.36; 35]** Në anketimin e studentëve, studentët u shprehën se stafi është i disponueshëm për t'i mbështetur. Gjithashtu, gjatë vlerësimit ata u shprehën se janë të kënaqur me mbështetjen që ofron stafi.**[Anketimi i studentëve; M4]** KUL-ja përdor një sërë qasjesh të mësimdhënies, duke përfshirë këtu vizita në gjykata dhe procese gjyqësore të simuluar, dhe leksione nëpër ministri apo departamente qeveritare përkatëse.**[RVV fq.32; EA3.9; M5]** KUL-ja rekruton staf me kualifikimet e duhura, dhe stafi me kohë të pjesshme sjellin me vete përvojë të pasur nga fushat e tyre përkatëse të profesionit.**[RVV fq.36; 17; GID; M5]** Në programet e studimit të ciklit të parë, 70 për qind e anëtarë të stafit përbëhet nga staf me kohë të plotë dhe 30 për qind nga staf me kohë të pjesshme.**[RVV fq.49; EA3.10]**
[Kapitulli I Standardi I.8]
- 3.9 Stafi akademik i kualifikuar kontribuon në hartimin e kurrikulës.**[RVV fq.36; EA3.11; M5]** KUL-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione publike dhe private, për të mbështetur gjetjen e praktikave dhe stazheve, **[RVV fq.37; EA3.12; M1; M6]** dhe profesionistë të fushave të ndryshme japin mësim në programet e Masterit Profesional.**[RVV fq.37; EA3.14; M1; M5]** Secili departament ka një grup kërkimor dhe çdo anëtar stafi merr pjesë në veprimtari kërkimore.**[RVV fq.36; GID; 6; 29]** KUL-ja organizon një sërë konferencash ndërkombëtare, dhe rreth 60 për qind e stafit përfshihet në botimin e raporteve shkencore të konferencave ndërkombëtare, dhe Kolegji

Universitar bashkëpunon me pesë institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me dy universitete ndërkombëtare. **[Anketimi i GID ; <http://www.luarasi-univ.edu.al/>; Anketimi i stafit] [Kapitulli I Standardi I.9]**

- 3.10 Programet e studimit në KUL janë me kohë të plotë dhe janë të hartuar dhe të ofruar në përputhje me Procesin e Bolonjës. Kurrikula është e ndarë në module dhe kredite që jepen në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, dhe për të rritur mundësitë e mobilitetit të studentëve, me anë të periudhave të studimit jashtë vendit, KUL-ja ka një numër në rritje të marrëveshjeve të partneritetit me universitete evropiane. **[RVV fq.37; 1; M1; M2]** KUL-ja ka një kuadër rregullator për menaxhimin e praktikave profesionale. **[67]** Ka rregullore për transferimin e studentëve dhe një komision i posaçëm vendos për ekuivalentimin e krediteve. Një numër i konsiderueshëm studentësh janë transferua brenda dhe jashtë Kolegjit Universitar, madje edhe jashtë vendit. **[RVV fq.37-38; 21 26; Anketimi i studentëve]** Gjuha angleze përfshihet në të gjitha programet e ciklit të parë, **[RVV fq.33; 8; 9]** dhe në mënyrë që studentët e ciklit të dytë të marrin diplomën, duhet që t'i nënshtrohen një provimi të gjuhës angleze. **[RVV fq.37; EA3-15; M4]** Shumica e studentëve u shprehën se janë të kënaqur me zhvillimin e gjuhëve të huaja. **[Anketimi i studentëve]** Pothuajse 30 për qind e stafit akademik kanë punuar jashtë vendit gjatë pesë viteve të fundit. **[Anketimi i stafit]** dhe 80 për qind e stafit u shprehën se ndërkombëtarizimi i Kolegjit Universitar është një element i mirë. **[Anketimi i stafit]** Diploma që i jepet studentëve pas përfundimit të programit të studimit shoqërohet me suplementin e diplomës. **[RVV fq.37; EA3.8] [Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.11 KUL-ja organizon një sërë veprimtarish ekstrakurrikulare, duke filluar që nga seminare të organizuara nga organizata jofitimprurëse, e deri te veprimtaritë sportive ndëruniversitare apo panairët e biznesit. **[RVV fq.38; <http://www.luarasi-univ.edu.al/>; M4]** KUL-ja ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe ndërmarrje private për zhvillimin e praktikës profesionale dhe stazheve. Studentët u shprehën me pozitivitet për mundësitë e tyre që të integrojnë teorinë me praktikën, gjatë programeve të tyre të studimit, kryesisht gjatë stazheve. **[RVV; fq.38; M1; M4; M6] [Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.12 Kurrikulat e KUL-së ofrojnë orientim profesional, lidhen ngushtësisht me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit, dhe janë zhvilluar në bashkëpunim me palët e interesit. **[RVV fq.39; 4; GID; M1; M2; M3; M6]** Programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë kanë të përfshirë në to stazhe dhe temat e diplomës, **[RVV fq.39; 1]** dhe për t'i mbështetur këto KUL-ja ka lidhur një sërë marrëveshjesh me institucione publike dhe me ndërmarrje private, për sa i përket ofrimit të vendeve të praktikës profesionale dhe të stazheve. Ai ruan marrëdhënie të ngushta dhe të shëndosha me punëdhënësit dhe alumni dhe shumë nga stafi akademik me kohë të pjeshme mundësojnë stazhe për studentët. **[RVV fq.39; EA3.12; M1; M2; M3; M6; M7]** Të gjithë studentët që morën pjesë në Anketimin e Studentëve u shprehën se janë të kënaqur me zhvillimin e aftësive profesionale dhe ata ndihen të sigurtë për mundësitë që kanë në tregun e punës. **[Anketimi i studentëve; M4]** Zyra e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës mban statistika për punësimin e të diplomuarve. **[RVV fq.37; EA3.13; M7] [Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Programet e studimit janë të organizuara për të marrë parasysh ekuilibrin ndërmjet lëndëve gjatë semestrave dhe viteve akademike, krahas ngarkesës mësimore të stafit akademik.[9.1; 9.2; M5] Ngarkesat mësimore përcaktohen nga përgjegjësi i departamentit dhe ndryshon nga lënda në lëndë. Praktika profesionale është një lëndë me detyrim për programet e ciklit të parë dhe të dytë dhe zhvillohet si në laboratorët mjeko-ligjore dhe të informatikës së Kolegjit Universitar, ashtu edhe në institucione të ndryshme, si në Gjykata dhe në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (Murgu), nën mbikëqyrjen e përbashkët të departamentit dhe institucionit pritës.[RVV fq.42; 68; M4; M5; M6] Pas përfundimit të praktikës profesionale, studenti dorëzon një dosje me dokumentet e praktikës, që vlerësohet nga një komision për praktikën.[FE4,6] Gjithashtu, performanca e studentit gjatë praktikës profesionale vlerësohet edhe nga punëdhënësi pritës.[M7] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron mundësitë gjithëpërfshirëse dhe cilësore të praktikave profesionale, që i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme për një karrierë të suksesshme, si një praktikë të mirë. Biblioteka ofron një mori me libra në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, si edhe akses në burimet online; ofron tekste të literaturës së detyrueshme dhe asaj mbështetëse për secilin program studimi që ofron.[RVV; fq.42; M4; M6; anketimi i studentëve]/Kapitulli I Standardi II.1]
- 4.2 Studentët që plotësojnë kërkesat përkatëse të vlerësimit iu jepet një diplomë. Vlerësimi i studentëve mbështetet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm. Rregulloret përcaktojnë formatin dhe strukturën e tezës dhe procedurën e provimit.[2; 68] Informacionet për procedurat e provimeve iu vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik, dhe rregulloret dhe procedurat e provimeve përcaktohen në Rregulloret e Brendshme të Kolegjit Universitar “Luarasi”; rregulloret e provimeve janë të disponueshme në faqen e internetit të Kolegjit Universitar.[2; 72; <http://www.luarasi-univ.edu.al/>] Kolegji Universitar mbështet parimin e konfidencialitetit në provime, dhe rezultatet e provimeve afishohen nga pedagogu në një vend të dukshëm dhe dokumentohen në regjistrin e vlerësimeve.[73; 74] Ka procedura të nevojshme që studentët të ankohen për procedurat e provimeve.[72; Anketimi i studentëve] Ankesat për pikët e vlerësimeve rishikohen nga një komision i posaçëm, i ngritur nga përgjegjësi i departamentit, me qëllim vërtetimin e pretendimit të studentit.[72] Struktura dhe detajet e temës së diplomës janë të përcaktuara në përputhje me rregulloret e secilit departament dhe mbrojtja e temës bëhet përpara komisionit të vlerësimit.[2] Në Anketimin e studentëve, pothuajse të gjithë studentët u shprehën se janë të kënaqur me proceset e vlerësimit.[RVV fq.44 ; 2; Anketimi i studentëve] [Kapitulli I Standardi II.2]
- 4.3 Përmirësimi i programeve të studimit arrihet përmes disa proceseve të ndërthurura, duke përfshirë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani, anketimet semestrale të studentëve dhe vizitat e vlerësimit të performancës, të organizuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.[RVV fq.46; 23; M3; M4; M5; M7] Nën drejtimin e Rektoratit, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit një raport vjetor, ku përfshihen rezultatet e Anketimit të studentëve, që i dërgohen Rektorit dhe përgjegjësve të departamenteve, dhe që janë të disponueshme për organet drejtuese të Kolegjit Universitar dhe shpërndahen me anë të emailit.[25; 75; FE2; M3; M4; M6] Mbështetur në rezultatet e anketimit të studentëve dhe në intervistat me stafin akademik, departamentet dhe Kolegji Universitar i vlerësojnë rregullisht programet, duke i marrë shumë seriozisht rezultatet dhe sugjerimet e studentëve.[46; FE9; FE13; FE24; FE25; M5] Zyra e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e Burimeve Njerëzore nxjerrin përfundimet për prirjet e tregut të punës dhe këto i përdorin për të mbështetur zhvillimin e kurrikulës në fusha, si

informatika dhe siguria, ekonomia, dhe rendi publik.[RVV; fq.46; FE40; FE40-1; FE40-2; M2; M7][Kapitulli I Standardi II.3]

- 4.4 Cilësia e mësimdhënies përmirësohet vazhdimisht nga stafi që merr pjesë në trajnime për mësimdhënien dhe veprimtarinë kërkimore, ku përfshihen pedagogët me kohë të pjesshme dhe të plotë.[RVV fq.47; EA4.8] Pedagogët nxiten të marrin pjesë në veprimtari kërkimore si brenda, ashtu edhe jashtë Kolegjit Universitar, dhe të publikojnë të gazetata e KUL-së, “Meditum” dhe “Tribunë Juridike”, po ashtu edhe në gazeta të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.[76; 24] Gjatë vlerësimit vjetor të performancës së stafit, bisedohet me stafin për të identifikuar pikat e tyre të forta dhe të dobëta, dhe stafit me performancë të ultë iu jepet kohë për t’u përmirësuar.[31; M2; M3; M5] Kolegji Universitar pohon se stafi duhet të marrë pjesë në më shumë trajnime për mësimdhënien dhe të nxënit, por e nxit stafin të marrë pjesë në seanca trajnime ose në tryeza të rrumbullakëta për metodat e mësimdhënies dhe të nxënit, si për shembull: një kurs dyditor për zhvillimin e pedagogëve, që zhvillohet nga Universiteti “London School of Economics”. Gjithashtu, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë po planifikon të organizojë një seancë për zhvillimin e stafit, ku kolegët mund të ndajnë praktikën më të mira me njëri-tjetrin. Gjatë vlerësimit, stafi u ndal veçanërisht në përqendrimin të zhvillimit të stafit për të përmirësuar performancën e ulët, dhe Kolegji Universitar mund të shqyrtojë si të zhvillohet mjaftueshëm stafi i tij, për të rritur nivelin e cilësisë së mësimdhënies në tërësi.[RVV; fq.31; EA4-8; M1; M2; M3; M7][Kapitulli I Standardi II.4]
- 4.5 Njësia bazë e mësimdhënies dhe kërkimore në KUL është departamenti. Secili përgjegjës departamenti mbikëqyr veprimtaritë kërkimore të kryera nga stafi akademik individualisht apo në grup, dhe harton një plan vjetor për ecurinë e kërkimeve, të cilin ia dërgon Këshillit të Fakultetit.[RVV fq.48-49; 6; M3] Plani strategjik i vitit 2016-2020 identifikon si dobësi mungesën e fondeve për të mbështetur zhvillimin shkencor, por gjatë semestrit të fundit, në përputhje me qëllimet strategjike, Kolegji Universitar i dha fonde të dyja fakulteteve për të zhvilluar një konferencë, përkatësisht Konferencën “Inovacioni dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm” dhe Konferencën “E drejta e pronës”. [4 fq.6-7; <http://www.luarasi-univ.edu.al/kerkimi-shkencor/>; M3; M5][Kapitulli II Standardi I.1]
- 4.6 Kolegji Universitar e nxit stafin akademik të marrë pjesë në veprimtaritë e kërkimit shkencor, si individualisht, ashtu edhe në grup kërkimor, dhe iu kërkohet të marrin pjesë në konferenca ose të botojnë në gazeta.[RVV fq.49; M3; M5; M7] Anketimi i stafit identifikoi që pothuajse 60 për qind e stafit janë të angazhuar me botime në gazeta ndërkombëtare dhe që marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare.[Anketimi i stafit] Gjithashtu, KUL-ja bashkëpunon me qendra të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit.[RVV fq.49; 20; M3] Disa prej veprimtarive shkencore të stafit akademik janë të organizuara në bashkëpunim me institute të tjera kërkimore, si me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Barit dhe me Shkollën e Magjistraturës.[RVV fq.49; M7][Kapitulli II Standardi I.2]
- 4.7 Në mënyrë që të ngrejë kapacitetet, Kolegji Universitar promovon angazhimin e stafit në projekte me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë zhvillimin e konferencave dhe pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme shkencore.[11; 20; M7] Kolegji Universitar ka marrë pjesë në projekte, si “SALTUM” në bashkëpunim me universitete në SHBA, Kinë, Brazil dhe Itali. Për më tepër, e ka zgjeruar bashkëpunimin me Universitetin e Lodz në Poloni, dhe me Universitetin e Burgenland në Austri, duke mundësuar mobilitetin e studentëve.[RVV fq.49; EA3-19-30; M7] Kolegji Universitar ka marrëveshje me revista të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare, që e nxisin stafin të botojnë, si për shembull në: “Anglisticum”, “Diskutime”, “Reforma” dhe “ARC journals”, po ashtu edhe gazetata e tij shkencore.[RVV fq.50; 20; M5] Ai i promovon tekstet akademike dhe botimet e

ndryshme nëpërmjet Shtypit të Universitetit dhe bibliotekave online.[59; 20; M5; M7] Rektori ka nënshkruar disa marrëveshje partneriteti, me qëllim zgjerimin e dosjes së tij të bashkëpunimeve, dhe KUL-ja po lidh marrëveshje të tjera partneriteti me Institutin Shqiptaro-amerikan, me British Council (Këshillin Britanik) dhe me Institutin Demokratik Kombëtar.[M1]/Kapitulli II Standardi I.3]

4.8 KUL-ja promovon kërkimet përmes departamenteve. Në fillim të vitit akademik, Këshilli i Fakultetit i prezantohen disa plane kërkimore shkencore, dhe pas miratimit të tyre, zhvillohen planet e veprimit.[RVV fq.50; FE16] Gjithashtu, Kolegji Universitar nxit debate shkencore ndërmjet stafit akademik.[RVV fq.50; M5] Në fillim të vitit akademik, stafi akademik harton planet specifike kërkimore, duke përfshirë botimet e planifikuara në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrjen në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimet e monografive, pjesëmarrjen në projekte shkencore dhe kualifikimet dhe titujt e marrë. Në fund të vitit akademik, çdo anëtar i stafit akademik prezanton një raport lidhur me realizimin e planit të tyre të punës për kërkimet shkencore. Me ndryshimet në ligjin e ri, KUL-ja ngriti qendrën "LUARASI IDEA", si një subjekt të veçantë ligjor, në mënyrë që të lehtësohej aplikimi për financimet e jashtme dhe zhvillimi i kërkimeve brenda Kolegjit Universitar.[AE15; FE17; FE18, M1, M3, M5]/Kapitulli III, Standardi I.4]

4.9 KUL-ja ofron të gjitha lehtësirat e nevojshme për të kryer kërkime, duke përfshirë literaturën, akses në internet dhe mbështetje financiare për projektet, konferencat dhe botimet e punëve kërkimore dhe të monografive të tyre.[RVV fq.51; 4; 59; 20; M3] Kolegji Universitar synon rekrutimin e stafit akademik të kualifikuar, dhe departamenti përcakton kriteret përkatëse në fillim të procesit të rekrutimit, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në planin strategjik të zhvillimit.[RVV fq.51; 4] Secili anëtar i stafit akademik plotëson një formular në fillim të vitit akademik, ku ata përcaktojnë qëllimet e tyre të kërkimit, dhe në fund të vitit akademik, monitorohen arritjet e kërkimeve të kryera nga stafi.[M3] Në përputhje me misionin e tij, KUL-ja synon të përgatisë studentët për nivelet elitare në fushat e ekonomisë dhe drejtësisë dhe planet e tij kërkimore mbështeten në këto fusha.[RVV fq. 51; 4] [Kapitulli II Standardi I.5]

4.10 Kolegji Universitar ka një strategji pesëvjeçare zhvillimi, e cila synon mbështetjen e ndërkombëtarizimit, zhvillimit të projekteve dhe kërkimit shkencor.[4] Veprimtaritë kërkimore të stafit akademik janë reale për fazën aktuale të zhvillimit të Kolegjit Universitar, që ofron vetëm programe deri në nivel Master. Lidhur me këtë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron veprimtarinë e kërkimeve shkencore si thelbësore, me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies, siç është mundësia e disa studentëve të nivelit Master të kryejnë kërkime në kompaninë "Birra Korça".[RVV fq.51; 20; M5] Për sa i përket zbatimit të Planit Strategjik, KUL-ja përgatiti një plan veprimi që përfshin kërkimet, dhe për vitin akademik 2016-2017 e deri më tani ka arritur dy objektiva me organizimin e dy konferencave vjetore.[4; FE16; <http://www.luarasi-univ.edu.al/kerkimi-shkencor/>] Gjithashtu, KUL-ja ka organizuar edhe promovime librash në bashkëpunim me institucioni të tjera, si Universiteti i Tiranës, Universiteti Evropian Juglindor i Kosovës, dhe Ambasada e Republikës së Kroacisë.[76; 77; M7; M5] KUL-ja e nxit mobilitetin ekonomik dhe fton kërkues të huaj nga institute prestigjioze evropiane shkencore që të mbajnë leksione dhe të zhvillojnë debate shkencore në kuadër të ndërkombëtarizimit të procesit akademik, si kolegët nga Shkolla e Menaxhimit Bocconi, në Itali.[RVV fq.53; <http://www.sdabocconi.it/en/faculty/>; M3] Deri më sot, gjashtë studentë dhe pesë anëtarë nga stafi akademik i KUL-së kanë përfituar nga programi i shkëmbimit ndërkombëtar.[EA4-4; Anketimi i studentëve; M4] KUL-ja mund të marrë në konsideratë përforsimin në këtë drejtim, në mënyrë që të përmirësohet dhe të rritet ndërkombëtarizimi.[Kapitulli II, Standardi I.6]

- 4.11 Rezultatet e kërkimit prezantohen në konferenca dhe simpoziume shkencore të organizuara nga KUL-ja, dhe botohen në buletine, në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe në ato të botuara nga KUL-ja. **[RVV fq.53; 20; M5; M7]** Në fund të vitit akademik, përgatitet një raport vjetor për botimet dhe pjesëmarrjen e stafit në konferenca. **[20;59]** ***[Kapitulli II Standardi I.7]***
- 4.12 Kolegji Universitar i monitoron dhe vlerëson rregullisht rezultatet e punës kërkimore të stafit të tij akademik dhe ka ngritur një Njësi Koordinimi për Kërkimin Shkencor, që është përgjegjëse për koordinimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor të KUL-së. **[RVV fq.53; M1; M3]** KUL-ja i përmbahet kriterëve të përcaktuara gjatë rekrutimit të stafit dhe vlerësimit të performancës së stafit akademik. **[AE4-13]** Kolegji Universitar është zotuar për transferimin e rezultateve të kërkimit në shoqërinë më të gjerë dhe ka dhënë dy shembuj ku rezultatet shkencore janë botuar në dy revista që menaxhohen nga KUL-ja, "Tribunë Juridike" dhe "Meditum". **[59; M3; M5]** Falë marrëveshjes bashkëpunuese me një nga grupet kryesore mediatike, shumica e veprimtarive kërkimore të Kolegjit Universitar mbulohen nga media. **[RVV fq.53; M5]** KUL-ja bashkëpunon me biznese dhe organizata ligjore në Shqipëri, si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Grupi Hysenbelliu dhe Banka Credins Shqipëri, me qëllim përmirësimin e praktikave të mësimdhënies, dhe falë këtyre marrëdhënieve studentëve iu ofrohen mundësi për zhvillimin e stazhit. **[RVV fq.54; M6]** ***[Kapitulli II Standardi I.8]***

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë:

- mundësitë e praktikës gjithëpërfshirëse dhe cilësore profesionale, që i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme për një karrierë të suksesshme (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Regjistrimi i studentëve mbështetet në legjislacionin aktual dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit institucional. **[4]** Kriteret e pranimit publikohen online, nëpër fletëpalosje informuese, dhe në fushata mediatike, dhe në vizitat nëpër shkollat e mesme. <http://www.luarasi-univ.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimit-2017-2018/>; **52; 58]** Në mënyrë që të informohen studentët e mundshëm, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës koordinon veprimtari pranimi dhe bashkëpunon me departamentet për të organizuar veprimtari promovuese me maurantët. **[79]** Ndërmerren një sërë veprimtarish pranimi, duke përfshirë ditë të hapura, pjesëmarrje në panairë arsimore dhe këshillimi për aplikantët. **RVV fq.55; 79; 78; 52]** KUL-ja i vlerëson veprimtaritë e pranimit që organizon. **[EA5-1]** Kolegji Universitar mirëpret studentë të rinj, dhe i ndihmon ata në integrimin e tyre në jetën universitare dhe i njeh ata me kurrikulën e programeve. **[RVV fq.56; 4; 79; M5]** KUL-ja bashkëpunon ngushtësisht me Drejtorinë Arsimore Rajonale për organizimin e veprimtarive promovuese. **[RVV fq.56; 4 fq.20]** Lidhur me komunikimin me studentët, Kolegji Universitar i publikon oraret e pritjes në faqen e tij të internetit dhe ngre stenda afër Sekretarisë Mësimore. **[RVV fq.56; 79; M7 <http://www.luarasi-univ.edu.al/>]** Raporti i përgjithshëm studentë-staf akademik është 12:1. Raporti studentë-staf akademik ndryshon pak në varësi të fakultetit. Në fakultetin e Drejtësisë raporti është 8:1, ndërsa në Fakultetin e Ekonomisë është 6:1. **[RVV fq.56; EA5-4; M3]** *[Kapitulli I Standardi III.1]*
- 5.2 KUL-ja iu ofron studentëve këshillime dhe mbështetje përmes zyrave për studentët, ofron edhe këshillim për karrierën, gjatë të cilit studentët mund të marrin informacione për organizimin e forumeve të hapura, trajnimeve, stazheve, dhe veprimtarive sociale dhe sportive. **[RVV fq.56; 34; 79]** Përdoren një sërë metodash komunikimi, duke përfshirë interneti, email/telefonin, faqen e internetit, reklamimin i rregullt, afishet, fletëpalosjet, dhe stendat e informacionit. **[RVV fq.57; <http://www.luarasi-univ.edu.al/>; M5; M7; FE1]** Secila nga Sekretaritë e fakultetit mban një dosje personale për secilin student, ku përfshihen dëftesa origjinale e shkollës së mesme, lista e notave, kontrata e regjistrimit të studentit, një fotokopje të kartës së tyre të identitetit, adresa dhe numri i tyre i kontaktit. **RVV fq.57; 80; Turi]** *[Kapitulli III Standardi III.2]*
- 5.3 Zyra e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës i ndihmon studentët të marrin informacionet që iu nevojiten dhe i ndihmon gjatë procesit të orientimit. **[RVV fq.57; M5]** Ajo i mbështet studentët që duan të ndryshojnë programin e tyre të studimit, që arrihet në përputhje me Rregulloret e Brendshme të Kolegjit Universitar. **[RVV fq.57; 2; M4]** Politika e tutoratit përcakton se si stafi akademik e zhvillon procesin e mentorimit, dhe studentët u shprehën pozitivisht për mbështetjen e marrë dhe për disponueshmërinë e stafit. Gjithashtu, u shprehën se stafi i konsideron ato si kolegë. **[EA5-5; M4; M5]** Në fund të çdo viti akademik, secili tutor përgatit një raport për përgjegjësin e departamentit lidhur me tutorimin e grupeve të studentëve, në të cilin japin rekomandime për përmirësim. **[FE5; M4; M5]** *[Kapitulli I Standardi III.3]*
- 5.4 Pas “Procedurës për trajtimin e studentëve me grante”, studentëve me aftësi të kufizuara dhe atyre që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, iu jepen bursa sociale. **[32]** Deri më sot, nuk është rekrutuar asnjë student me aftësi të kufizuara, por gjatë vitit të fundit akademik, numri i bursave të dhëna është shumëfishuar, nga 14 në vitin 2015-2016, në 77 për vitin akademik 2016-2017. **[32; EA5-3]** Përfituesi i bursës monitorohet gjatë vitit, dhe nëse ai nuk ka performancë të mirë, ekziston mundësia që vitin e ardhshëm t’i hiqet bursa. **[M3]** Kolegji Universitar iu ofron mbështetje studentëve që janë atletë. **[EA5-6; M4]** Kolegji nuk ofron studime me kohë të pjesëshme. **[GID]** *[Kapitulli I Standardi III.4]*
- 5.5 Kolegji Universitar i pajis studentët me literaturë që gjendet në bibliotekë dhe me materiale të shkruara nga pedagogët, dhe nga Shtypi i Universitetit Luarasi dhe

libraria. **[82]** Biblioteka mundëson aksesin në burimet elektronike që ofrojnë materiale falas, duke përfshirë libra dhe revista të huaja. **[FE82.1; 82.2]** Biblioteka ka 2,543 libra, 763 prej të cilëve janë në gjuhën angleze. **[36; FE82]** KUL-ja pasuron fondi e librave për secilin program studimi dhe për arsye kërkimore. Studentët japin mendimet e tyre përmes anketimeve ose duke bërë ankesë, nëse nuk gjendet një libër i caktuar. Nganjëherë pedagogët janë autorët e librave që nevojiten për kursin e tyre, me anë të burimeve të tyre. **[RVV fq.58; M3]** Studentët u shprehën të kënaqur me disponueshmërinë e teksteve në bibliotekë. **[Anketimi i studentëve]**. Janë të disponueshme një sërë bibliotekash online, që klasifikohen sipas secilit fakultet. Biblioteka është e hapur nga ora 8:30 deri në 14:00 dhe nga 15:30 deri në 19:00. **[RVV fq.58 ; M4; Anketimi i studentëve]** **[Kapitulli I Standardi III.5]**

- 5.6 Studentëve iu ofrohet tutorim gjatë gjithë vitit akademik. Kolegji Universitar këshillon që secili student të ketë të njëjtin tutor gjatë ciklit të tyre të studimit. **[35]** Mbështetja për studimet akademike ofrohet nga pedagogët e kurseve. **[10; M4]** Studentët që hasin vështirësi mbështeten përmes disa seancave orientimi dhe konsultimi. **[35]** Këshilli i Fakultetit vlerëson efikasitetin e shërbimit të tutoriatit. Kjo bëhet përmes pyetësorëve të zhvilluar në bashkëpunim me studentët, në të cilat studentët japin një gjykim anonim lidhur me performancën dhe efikasitetin e tutoriatit kolektiv dhe individual. **[EA5-8; M4; M7]** Koordinator i fakultetit për tutoriatin, në bashkëpunim me koordinatoren e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, harton një raport vjetor për shërbimin e tutoriatit, që i dorëzohet Këshillit të Fakultetit. **[FE5]** **[Kapitulli I Standard III.6]**
- 5.7 Studentët kanë përfaqësues në organet drejtuese të kolegjit universitar, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme të tij. **[2; 83; M3]** Studentët organizojnë veprimtari të ndryshme brenda kuadrit të Këshillit Studentor dhe vetëpërfaqësohen në strukturat drejtuese të mësimdhënies dhe kërkimit në Kolegjin Universitar. Ata japin mendimet e tyre dhe bëjnë propozime përmes Këshillit Studentor, siç përcaktohet në Statut dhe nga përbërja e Këshillit studentor. KUL-ja i mbështet veprimtaritë studentore përmes Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. KUL-ja ofron mbështetje financiare për veprimtaritë e organizuara nga Këshilli Studentor, i cili ka krijuar klubin e studentëve, një gazetë, dhe në përgjigje të kërkesave të studentëve, ka një marrëdhënie me një Këshill Studentor në Kosovë. **[83; M4]** **[Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.8 Studentët mbështeten në arritjet e tyre personale, sociale, akademike nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, që mbështet jetën kulturore në KUL. Një shembull i kësaj mbështetjeje janë vizitat turistike, veprimtaritë artistike dhe sportive. **[RVV fq.60; 56; M4; Anketimi i studentëve]** KUL-ja ka marrëveshje me kompleksin sportiv “Ali Demi” dhe me godina private sportive ku studentët mund të marrin pjesë në një sërë veprimtarish sportive, si futboll dhe volejboll. **[M4]** KUL-ja ka nënshkruar marrëveshje me një shoqëri sigurimi për garantimin e shëndetit të studentëve. **[79; FE14; Anketimi i studentëve]** **[Kapitulli I Standardi III.8]**
- 5.9 Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës është përgjegjëse për regjistrimin e statistikave të punësimit të të diplomuarve. **[RVV fq.60; 47; 84]** Kolegji Universitar ndjek disa politika për punësimin e të diplomuarve të tij, si për shembull: iu ka ofruar atyre një klinikë ligjore, funksioni kryesor i së cilës është ofrimi i ndihmës ligjore në gjykata për ata që i përballojnë dot shpenzimet për mbrojtjen ligjore. **[84; M4]** Ka lidhur 29 marrëveshje, shumë prej të cilave janë me institucione publike dhe private dhe ndërmarrje të rëndësishme, si Parlamenti i Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Bordi i Autoritetit Shqiptar të Mbikëqyrjes Financiare, Policia e Shtetit, Drejtoria Shqiptare e Patentave, Grupi Hysenbelliu dhe një sërë përfaqësues të sistemit gjyqësor. Një sërë individësh nga këto organizata janë punësuar si staf me kohë të pjesshme. **[RVV fq.60; M6]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mbështetjen e gjerë për punësueshmërinë në KUL

nga profesionistë të nivelit të lartë dhe specialistë si akademik me kohë të pjesshme si **praktikë të mirë.** *[Kapitulli I Standardi III.9]*

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë:

- mbështetja e gjerë për punësueshmërinë në KLU e ofruar nga profesionistë të nivelit të lartë dhe nga ekspertë si staf akademik me kohë të pjesshme (pika 5.9; Kapitulli I Standardi III.9).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

RVV

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
1		Fjala e Rektorit
2	GID	Dokument me informacione të përgjithshme
3	RVV	Raporti i Vetëvlerësimit
4	1	Statuti
5	2	Rregulloret
6	3	Struktura organizative
7	4	Plani strategjik
8	5	Rregulloret e fakultetit - Në gjuhën shqipe
9	6	Rregulloret e departamentit - Në gjuhën shqipe
10	7	Rregulloret e programit - Në gjuhën shqipe
11	8	Programet e studimit
12	9	Planet e studimit
13	10	Syllabuset
14	11	Bashkëpunimi ndërkombëtar - - Në gjuhën shqipe
15	12	Buxheti vjetor
16	13	Raporti i Buxhetit vjetor - Në gjuhën shqipe
17	14	Tarifa e shkollimit - Në gjuhën shqipe
18	15	Vlerësimi financiar - Në gjuhën shqipe
19	16	Raportet e auditimit - Në gjuhën shqipe
20	17	Lista e personelit - Në gjuhën shqipe
21	18	Kontratat me stafin akademik - Në gjuhën shqipe
22	19	Kontratat me studentët - Në gjuhën shqipe
23	20	Raporti për veprimtaritë shkencore
24	21	
25	22	Infrastruktura e KUL-së
26	23	Rregullorja e organizimit të studimeve
27	24	Manuali i Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
28	25	Procedura për shqyrtimin e programeve të studimit dhe raporteve - Në gjuhën shqipe
29	26	Procedurat e transferimit të studentëve
30	27	Kualifikimet e stafit akademik
31	28	Evidenca të komisioneve të vlerësimit (shembuj) - Në gjuhën shqipe
32	29	Raport për veprimtarinë kërkimore akademike të stafit akademik
33	30	Raporti i ERASMUS + - Në gjuhën shqipe
34	31	Treguesit e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies - Në gjuhën shqipe
35	32	Procedura e dhënies së bursave për studentët
36	33	Vendimet e Organeve Kolegjiale - Në gjuhën shqipe
37	34	Raportet e Zyrës së Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës - Në gjuhën shqipe
38	35	Rregullorja e tutoriatit
39	36	Stoku i bibliotekës - Në gjuhën shqipe
40	37	Treguesit e performancës së studentëve (statistikat)
41	38	Anëtarët/Përfaqësuesit e organeve të Kolegjit Universitar "Luarasi" - Në gjuhën shqipe

42	39	Kontrata e qirasë dhe planimetria e pronës - Në gjuhën shqipe
43	40	Libri i Karrierës - Në gjuhën shqipe
44	41	Formulari i veprimtarive Kërkimore-Shkencore - Në gjuhën shqipe
45	42	Treguesi i performancës - Në gjuhën shqipe
46	43	Përbërja e Senatit Akademik, ZSBC-së dhe Këshillit të Etikës - Në gjuhën shqipe
47	44	Kriteret e pranimit të studentëve - Në gjuhën shqipe
48	45	Faqja e internetit/emaili/faqja në Youtube - Në gjuhën shqipe
49	46	Raportet e mbledhjeve dhe të organeve vendimmarrëse - Në gjuhën shqipe
50	47	Të dhëna për punësimin e studentëve - Në gjuhën shqipe
51	48	Veprimtaritë e alumni - Në gjuhën shqipe
52	49	Studim i tregut të punës për hapjen e programeve të reja - Në gjuhën shqipe
53	50	Të dhëna për bashkëpunimin ndërinstitucional - Në gjuhën shqipe
54	51	shembull procedure punësimi - Në gjuhën shqipe
55	52	Fletëpalosje promovuese - Në gjuhën shqipe
56	53	Korrespondenca me DAR dhe axhenda e vizitave në shkolla - Në gjuhën shqipe
57	54	Bashkëpunimi me Universitetin “Aleksandër Moisiu”
58	55	Urdhrat për emërimin e përgjegjësve të departamenteve -Në gjuhën shqipe
59	56	Të dhëna për veprimtaritë e studentëve - Në gjuhën shqipe
60	57	Akti i marrëveshjes ndërmjet Sicred-Luarasi - Në gjuhën shqipe
61	58	Të dhëna sasiore për mjetet - Në gjuhën shqipe
62	59	Botimet Luarasi - Në gjuhën shqipe
63	60	Model i anketimit të studentëve - Në gjuhën shqipe
64	61	Kontrata me IPPM
65	62	Lejet e higjieno-sanitare dhe të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri - Në gjuhën shqipe
66	63	Akti i vlerësimit të ndërtimeve MAS - Në gjuhën shqipe
67	64	Shembull i dosjes me notat/regjistrimin/diplomimin - Në gjuhën shqipe
68	65	Kontrata e klinikës ligjore - Në gjuhën shqipe
69	66	Procedurat për krijimin e programeve të reja - Në gjuhën shqipe
70	67	Udhëzuesi i praktikës - Në gjuhën shqipe
71	68	Rregulloret/udhëzimet për mrbojtën e temës së diplomës - Në gjuhën shqipe
72	69	Vendimet për praktikat e tarifës shkollore - Në gjuhën shqipe
73	70	Vendimi për miratimin e temave të diplomës - Në gjuhën shqipe
74	71	Vendimi për komisionet e përhershme të fakultetit dhe institucionit - Në gjuhën shqipe
75	72	Rregulloret e provimeve - Në gjuhën shqipe
76	73	Raportet e provimeve - Në gjuhën shqipe
77	74	Pyetësor për pedagogët - Në gjuhën shqipe
78	75	Pyetësor për vlerësimin e programeve - Në gjuhën shqipe
79	76	Liste konferencave dhe temave të tyre - Në gjuhën shqipe

80	77	Raporti i Zyrës së Marrëdhënieve me publikun
81	78	Fotografi nga aktivitetet promovuese të Kolegjit Universitar "Luarasi" - Në gjuhën shqipe
82	79	Zyra e Këshillimit të Karrierës - Në gjuhën shqipe
83	80	Formulari i aplikimit i studentëve - Në gjuhën shqipe
84	81	Listë më leksione të hapura - Në gjuhën shqipe
85	82	Evidencë të bibliotekës online, fondi i bibliotekës - Në gjuhën shqipe
86	83	Statuti dhe përbërja e Këshillit Studentor - Në gjuhën shqipe
87	84	Lista e studentëve të punësuar pranë Kolegjin Universitar 'Luarasi' - Në gjuhën shqipe

Dokumente shtesë (AE)

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
15		Përgjigja për dokumentacione shtesë
16	EA1-14	Strategjia për Bashkëpunim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
17	EA2.6	Studime ndërkombëtare të personelit
18	EA2-5 Nr2	Paneli i emërimit të personelit
19	EA2-5 Nr3	Vendet e lira të punës për personelin - specifikimet
20	EA2-5 Nr4	Raporti i emërimit të personelit
21	EA2-5 Nr5	Letrat e motivimit për emërimin e personelit
22	EA2-5 Nr6	Raporti i emërimit të personelit
23	EA2-5 Nr1	Procedurat e rekrutimit
24	EA3.1.1	Adresa e DAR-it - Në gjuhën shqipe
25	EA3.10	Personeli - Në gjuhën shqipe
26	EA3.12.1	Memorandumi i bashkëpunimit
27	EA3-8.1	Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi - Në gjuhën shqipe
28	EA308.2	Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi - Përkthimi
29	EA3-8Nr3	Suplementi i diplomës
30	EA3-8Nr2	Lista e notave - Në gjuhën shqipe
31	EA3-12	Marrëveshja e bashkëpunimit
32	EA3-19-11	Strategjia për bashkëpunim dhe bashkëpunim ndërkombëtar - Partneritetet
33	EA3-19-30	Raporti i programeve të ERASMUS
34	EA3-19-67	Udhëzimet e praktikës
35	EA4-11	Raporti për veprimtarinë kërkimore të stafit akademik
36	EA5-3	Statistikat e bursave
37	EA1-2	Trajnime për studentët e zgjedhur në komisionet zyrtare
38	EA1-4	URL e raportit vjetor
39	EA1-6	Dokumentacioni i përfshirjes së personelit dhe studentëve në vendimmarrje
40	EA1-9	Dokumentacioni i studimit të tregut për të mbështetur zhvillimin e programeve
41	EA1-10	Shembuj të përfshirjes së palëve të jashtme të interesit në hartimin e programeve
42	EA1-12	Puna e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, lidhjet me alumni
43	EA1-15	Dokumentacioni i bashkëpunimit me institucione të tjera
44	EA2.6	Dokumentacioni e personelit të kualifikuar në universitete ndërkombëtare

45	EA2-1	Statusi i regjistrimit i Universitetit Luarasi
46	EA2-2	Dokumentacioni e orientimit dhe zhvillimit të personelit
47	EA3.10	Raporti staf-studentë
48	EA3-1	Kërkesë për vizitë në një shkollë të mesme
49	EA3-2	Kriteret e pranimit specifike të programeve
50	EA3-5	Dokumentacioni se si Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës përfton reagimet e studentëve
51	EA3-7	Shembuj të promovimit të kulturave të huaja
52	EA3-9	Dokumentacioni e qasjeve të ndryshme të mësimdhënies
53	EA3-11	Dokumentacioni për hapjen e programeve Master Profesional në Siguri dhe Rend Publik
54	EA3-12	Dokumentacioni i marrëveshjeve të bashkëpunimit që mbështesin praktikat profesionale
55	EA3-13	Statistika të punësimit të të diplomuarve
56	EA3-14	Dokumentacioni që tregon se profesionistë japin mësim në programet e Master Profesional në fushat e tyre
57	EA3-16	Raporti vjetor i Zyrës së Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë 2015-16
58	EA4-5	Manuali i Sigurimit të Cilësisë - vlerësimi i rregullt i programeve të studimit
59	EA4-7	Diskutime në tryezën e rrumbullakët – personeli dhe studentët
60	EA4-8	Deklaratë për workshop-et e personelit
61	EA4-8	Certifikatë e pjesëmarrjes në workshop-et e personelit
62	EA5-4	Dokumentacioni i raportit staf-studentë
63	EA5-5	Dokumentacioni për orientimin dhe mentorimin e studentëve
64	EA4-1.1	Buxheti i konferencave
65	EA1-1	Dokumentacioni se si studentët zgjidhen në Senatin Akademik, në Bordin e Etikës dhe komisione të tjera
66	EA3-15.1	Diplomë
67	EA1-7	Dokumentacioni i mbështetjes së stafit dhe studentëve për shkëmbimet ndërkombëtare
68	EA2-8	Kopje e procesverbaleve të mbledhjes së Senatit Akademik
69	EA2-9	Kopje e dokumenteve të Bordit të Administrimit që paraqesin shqyrtimin e buxhetit vjetor
70	EA3-3	Kushtet e regjistrimit në programe të ciklit të dytë të studimit, Master i Shkencave në të Drejtën Civile dhe Tregtare
71	EA3-6	Rezultatet e të nxënimit në nivel programi
72	EA3-15	Certifikatë arritjeje nga TOEFL
73	EA4-1	Buxheti i konferencave
74	EA4-12	Plan veprimi për zbatimin e Planit Strategjik 2016-17
75	EA4-13	Shembull i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore
76	EA5-1	Vlerësimi i veprimtarive të pranimit
77	EA5-6	Mbështetje për studentët atletë
78	EAR-18	Vizitat e Këshillit Studentor në Republikën e Kosovës
79	EAR-18-1	Fotografi e një studenti
80	EAR-18-2	Fotografi
81	EAR-18-3	Fotografi
82	EAR-18-4	Fotografi
83	E5-8	Pyetësori i studentëve - tutoriati
84	EA4-4	Dokumentacioni i shkëmbimeve ndërkombëtare të stafit dhe studentëve
85	EA1-16	Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit

Dokumente të mëtejshme (FE)

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
1	FE1	Email i dërguar studentëve për krijimin e sistemit online të Universitetit - Në gjuhën shqipe
2	FE2	Raporti i Grupit të Sigurimit të Cilësisë - Në gjuhën shqipe
3	FE 3.1	Miratimi i kritereve të pranimit - Në gjuhën shqipe
4	FE 3.2	Miratimi i kritereve të pranimit - Në gjuhën shqipe
5	FE 3.3	Miratimi i kritereve të pranimit - Në gjuhën shqipe
6	FE 3.4	Miratimi i kritereve të pranimit - Në gjuhën shqipe
7	FE 3.5	Miratimi i kritereve të pranimit - Në gjuhën shqipe
8	FE 3.6	Miratimi i kritereve të pranimit - Në gjuhën shqipe
9	82,1	Abonimi te revista "Economist"
10	82,2	Anëtarësimi vjetor në "Questia"
11	82	Librat në bibliotekë
12	25	Procedura për shqyrtimin e programeve të studimit dhe raporteve - Në gjuhën shqipe
13	FE 4	Materiale shpjeguese për praktikën- Në gjuhën shqipe
14	FE 5	Shembull i raportit të tutoriatit - Në gjuhën shqipe
15	FE 6	Përmbledhje e stazhit - Në gjuhën shqipe
16	FE 7	Raport vjetor për vitin akademik 2016 - Në gjuhën shqipe
17	FE 8	Udhëzues për praktikën - Në gjuhën shqipe
18	FE 9	Raport i vëzhgimit të orëve të mësimi- Në gjuhën shqipe
19	24	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
20	FE 10	Marrëveshje e bashkëpunimit - Në gjuhën shqipe
21	40	Libri i karrierës - Në gjuhën shqipe
22	40,1	Libri i karrierës - Në gjuhën shqipe
23	40,2	Libri i karrierës - Në gjuhën shqipe
24	FE 11	Listë e memorandumëve - Në gjuhën shqipe
25	FE 12	Formulari i praktikës - Në gjuhën shqipe
26	FE 13	Procesi i vlerësimit. Vlerësimi i stafit akademik - Në gjuhën shqipe
27	FE 14	Marrëveshje për sigurimet e studentëve - Në gjuhën shqipe
28	FE 16	Plani strategjik i kërkimeve - Në gjuhën shqipe
29	FE 17	Plani i veprimit "Luarasi IDEA" - Në gjuhën shqipe
30	FE 18	Dokumentacioni i Qendrës Kërkimore - Në gjuhën shqipe
31	FE 31	Kontrata për sistemin online
32	FE 19	Anëtarët e stafit të pranishëm gjatë vlerësimit të jashtëm

Mbledhjet

- M1 Mbledhja 1
- M2 Mbledhja 2
- M3 Mbledhja 3
- M4 Mbledhja 4
- M5 Mbledhja 5
- M6 Mbledhja 6
- M7 Mbledhja 7